



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 21/2009
Më 07. 07. 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Sala Berisha – Shala, Fatmir Rexhepi, Kaqusha Jashari, Berim Ramosaj dhe Zef Morina.

Munguan: Slobodan Petroviq, Safete Hadërgjonaj dhe Múfera Şinik.

Pjesëmarrës të tjerë: Remzije Hajdari dhe Hafiz Gora – MTI, Lejla Selimi – OSBE, Lumnije Murati –ZPRK, Rrezarta Ahmeti – KDI, Blerina Uka - Bullatovci - NDI dhe Ibrahim Krasniqi – konsulent i Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 30. 06. 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për standardizimin,
4. Të ndryshme.

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 30. 06. 2009

Procesverbali i mbledhjes së 30. 06. 2009 u miratua pa vërejtje.

III. Shqyrtimi i Projektligjit për standardizim

Kryetarja – E paraqiti në Komision, në emër të grupit të punës, Raportin me propozime për Projektligjin për standardizim. Grupi i punës kishte propozuar amendamente lidhur me nenet 1; 2; 3; 4.1; 4. 2; 5.1; 5.1,3; 8.4; 8.5; 10.1;10.4; 11.2; 12.1; 13.1.12; 17.3; 19.1; 19.2; dhe nenin 21.

Komisioni nuk u pajtua me amendamentin e propozuar lidhur me nenin 8.4 dhe mbetë ashtu si ishte në P/ligj.

Lidhur me propozimin e grupit të punës (neni 8.5) Komisioni nuk u pajtua dhe e miratoi amendamentin që e ndryshon paragrafin 8.5, si vijon: “Struktura organizative e AKS- së rregullohet me akt nënligjor”.

Propozimi i grupit të punës lidhur me nenin 11.2 nuk u miratua nga Komisioni dhe paragrafi 2 mbetet ashtu si ishte në P/ligj.

Sala Berisha – Shala – Propozoi që fjala: “standard-e”, në kontekst të standardizimit, në tërë tekstin e P/ligjit të zëvendësohet me fjalën: “standardizim”.

Amendamenti u votua “për” nga Komisioni dhe vendoset në kuadër të amendamentit 3.

Pas debatit të gjerë Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Miratohet Raporti me 14 amendamente për Projektligjin për standardizimin dhe procedohet për komisionet kryesore.

IV. Shqyrtimi i Planit të veprimit

Kryetarja – Ia paraqiti Komisionit Raportin e grupit të punës për Propozimplanin e veprimit të Kuvendit për sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008, që bie në detyrimet e Komisionit dhe kërkoi të miratohet.

Pas debatit Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Miratohet Raporti i grupit të punës për Propozimplanin e veprimit të Kuvendit për sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008.

V. Të ndryshme

a) Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për shpalljen e hapësirës – zonë me interes të veçantë ekonomik, në të cilin do të ndërtohet “Hidrocentrali i Zhurit”

Kryetarja – E njoftoi Komisionin për Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr. 03–P–132, datë 01. 07. 2009, në të cilin kërkohet që Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, së bashku me Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, ta shqyrtojnë propozimvendimin e Qeverisë së Kosovës për shpalljen e hapësirës – zonë me interes të veçantë ekonomik, ku do të ndërtohet “Hidrocentrali i Zhurit” dhe t’ia paraqesin Kuvendit Raportin me rekomandime.

Ethem Çeku – Tha se është dashur të kemi së pari material me të gjitha dokumentet nga MEM-i, për këtë çështje dhe pastaj ta diskutojmë. Edhe pse *a priori* ishte të mbështetej ky propozimvendim, theksoi se do të ishte e udhës të kishim Ligjin për planifikim hapësinor dhe kërkoi të ftohet MEM-i në Komision.

Fatmir Rexhepi – Shtoi se Komisionit i duhet kohë ta shqyrtojë këtë çështje, sepse është e një rëndësie të veçantë për vendin dhe duhet të kërkohen prej Qeverisë shpjegime më të thukta, se ajo zonë duhet të shpallet me interes të veçantë. Në fund theksoi se nuk është e nevojshme ta shqyrtojmë këtë çështje me ndonjë komision tjetër.

Zef Morina – Tha se duhet të përkrahet në parim ky propozimvendim i Qeverisë dhe u pajtua që të këtë arsyeshmëri për këtë projekt me anë të një programi adekuat. Komisioni për Bujqësi e ka edhe planifikimin hapësinor si fushë dhe mund të bashkëpunojmë edhe më atë komision.

Berim Ramosaj – Theksoi se në parim për këtë çështje anën e fizibilitetit teknik dhe ekonomik e ka Qeveria, mirëpo edhe Komisioni mund ta japë kontributin në këtë drejtim.

Sala Berisha – Shala – Tha se Komisioni duhet të përfshihet në shqyrtimin e këtij propozimvendimi që të shtyhet kjo çështje përpara.

Pas debatit Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Qeveria t’i ofrojë Komisionit material për propozimvendimin e shpalljes së hapësirës – zonë me interes të veçantë ekonomik, ku do të ndërtohet “Hidrocentrali i Zhurit”.

b) Pakoja e tenderit TC “Kosova e Re”

Ethem Çeku – Tha se duke marrë parasysh se tërë opinionin publik diskuton për çështjen e TC “Kosova e Re”, ndërkaq Komisioni nuk ka fare qasje dhe nuk diskuton fare për këtë çështje. Andaj kërkoj që në mbledhjen e radhës të ftohet ministrja e MEM-it, që të raportojë në Komision për Pakon tenderuese për TC ”Kosova e Re”.

Berim Ramosaj – Theksoi se në këtë çështje Qeveria po e anashkalon Komisionin dhe ofertuesi po i përcakton politikat e tenderimit. Po ashtu nuk po shikohet ana ekologjike, ajo e punësimit etj. Kërkoj që edhe Komisioni të jetë i involvuar në këtë çështje.

Fatmir Rexhepi – Tha se Komisioni së pari duhet të përgatitet për këtë çështje, pastaj të ftohet MEM-i. Kërkoj nga kryetarja dhe nënkryetari i Komisionit, që paraprakisht të takohet Komisioni dhe të nxirren konkluzat, pastaj të ftohet MEM-i.

Pas debatit Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Të ftohet Shiroka – Pula, ministre e Ministrisë së Minierave dhe e Mineraleve, që të raportojë në mbledhjen e Komisionit më 14. 07. 2009 për Pakon tenderuese të TC ”Kosova e Re”

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani